



Kompania Rajonale e Ujësjetësit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Gjakova” SH.A.
Gjakovë

PLANI PËR ZVOGËLIMIN E HUMBJEVE TË UJIT 2023

Maj, 2023

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	3
2.	GJENDJA EKZISTUESE.....	4
3.	CAQET E PËRCAKTUARA.....	5
4.	REDUKTIMI I HUMBJEVE APARENTE.....	6
4.1.	<i>Synimet Operative për Reduktimin e Humbjeve Aparente</i>	6
4.2.	<i>Aktivitetet e Planifikuara</i>	7
5.	REDUKTIMI I HUMBJEVE REALE (FIZIKE).....	7
5.1	<i>Synimet Operative për Zvogëlimin e Humbjeve Reale/Fizike</i>	7
5.2	<i>Aktivitetet e Planifikuara</i>	8
	SHTOJCA I: PLANI DINAMIK ME AKTIVITETE DHE BUXHETI I PLANIFIKUAR.....	9

SHKURTESAT

NJPMNP	Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
ARRU	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjesit
KRUGJ	Kompania Rajonale e Ujësjesit Gjakova
PZH	Plani për Zvogëlimin e humbjeve
UPF	Ujë i pa faturuar

I. HYRJE

Meqenëse uji bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm dhe i pakët viteve të fundit, duhet shtuar kujdes imediat për trajtimin me të mirë të sistemeve të furnizimit me ujë. Kjo nënkupton një ulje të kostos së menaxhimit të sistemit, e cila arrihet kryesisht nga mirëmbajtja më e mirë. Për më tepër, kjo në sistemet e furnizimit me ujë lidhet kryesisht me një kujdes të shtuar në zvogëlimin e humbjeve të ujit, që është parakushti themelor për një stabilitet të qëndrueshëm me furnizim afatgjatë.

Shkalla e ujit të humbur është një indikator i mirë i jo efijencës së sistemit dhe në korrelacion me indikatorët tjerë siç janë: efijenca financiare dhe efijenca operative. Reduktimi dhe kontrollimi i qëndrueshëm i UPF-së, në një sistem të ujësjellësit është një problem kompleks i cili kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale. Kjo për faktin se humbjet e ujit kanë tendencë natyrale të ngritjes nëse nuk ndërmerren masa adekuate për ndaljen/zvogëlimin e tyre: rrjedhjet nga gypat shtohen vazhdimisht, numri i ujëmatësve që nuk matin saktë rritet, të dhënat për konsumatorët nuk azhurnohen etj.

Ky plan ka për qëllim që të përkufizojë qasjen e KRU “Gjakova” Sh.A. (KRUGJ) si dhe aktivitetet të cilat do të ndërmerren në periudhën 2023, për reduktimin e ujit të pa-faturuar (UPF) me qëllim të përmbushjes së synimit të saj strategjik, që është: *‘Ofrimi i shërbimeve kualitative për të gjithë konsumatorët dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare’*. Këto aktivitete janë të mbështetura në analizimin e sasisë së ujit të humbur si dhe të faktorëve që ndikojnë në humbjet e ujit.

Në rastin e KRUGJ, reduktimi i humbjeve të ujit (UPF) paraqet padyshim një prej sfidave më të mëdha për faktin se aktualisht afër gjysma e ujit të trajtuar të cilin KRUGJ, e distribuon në sistem (prodhuar: 16,177,553 m³, faturuar: 8,585,438 m³, UPF: 7,592,137 m³, humbja 46.93% - viti 2022) nuk faturohet si pasojë qoftë e humbjeve fizike (rrjedhjet nga gypat) apo humbjeve komerciale (gabimet në matje dhe lexim, keqpërdorimet etj.).

Shkalla kaq e lartë e humbjeve të ujit, shkakton humbje substanciale financiare për Kompaninë. Është e qartë se KRUGJ nuk mund ti eliminojë në tërësi humbjet e ujit, megjithatë, Kompania do mundohet që vit pas viti të bëjë zvogëlimin e tyre.

Me qëllim të eliminimit të konfuzionit eventual lidhur me terminologjinë e cila përdoret kur bëhet fjalë për humbjet e ujit, në këtë plan është përdorur terminologjia standarde e adaptuar në metodologjinë për llogaritjen e bilancit uhor të Asociacionit Botëror të Ujërave (IWA), ku humbjet e ujit ndahen në:

- **Humbjet aparente (komerciale), dhe**
- **Humbjet reale (fizike).**

Ky plan do të rishikohet në baza vjetore. Njëkohësisht, me qëllim të sigurimit të një qasjeje të integruar në zbatimin e këtij plani, KRUGJ, ka emëruar **Koordinatorin për Humbje të Ujit** që do të koordinon aktivitetet e planifikuara.

Koordinatori i UPF-së, ne koordinim me Departamentin Komercial dhe Departamentin Teknik, do të raportojë në baza të rregullta (muajore) tek Menaxhmenti i Kompanisë për progresin në arritjen e synimeve të përcaktuara /zvogëlimin e humbjeve të ujit/, dhe ne baza tremujore te NJPMNP/ME.

2. GJENDJA EKZISTUESE

Parakusht për hartimin dhe implementimin e këtij plani për zvogëlimin e humbjeve të ujit është identifikimi i gjendjes ekzistuese në bazë të cilit pastaj mund të projektohen masat e duhura dhe të zhvillohet një program efektiv për reduktimin e UPF.

Në këtë kontekst, duhet analizuar pyetjet bazike si:

- (i) Sa ujë humbet?
- (ii) Ku humbet? dhe
- (iii) Pse humbet?

Është me rëndësi esenciale për adaptimin dhe implementimin e zgjidhjeve praktike për zvogëlimin e humbjeve të ujit.

- (i) Shkalla e humbjeve të ujit (Sa janë humbjet e ujit?)
Shkalla e humbjeve të ujit për zonën e shërbimit të KRU 'Gjakova' (KRUGJ) në vitin 2022 kanë qenë 46.93 %, ne tremujorin e parë të vitit 2023, kemi shkallën e humbjeve 50.50%.
- (ii) Kuantifikimi (përcaktimi vëllimor) i humbjeve reale dhe aparente (Ku humbet uji?)
Kompania aktualisht nuk është në gjendje të kuantifikojë sasinë e humbjeve aparente dhe humbjeve reale në totalin e humbjeve të ujit, megjithatë sipas vlerësimit nga Moduli i bilancit të ujit për vitin 2022, kemi humbje teknike 67%, dhe humbje komerciale 33%, ku sipas ekspertëve te zyrës se planifikimit kjo % është e barabartë në teren.
- (iii) Shkaqet për humbjet e ujit (Pse humbet uji?)
Shkaqet për këtë shkallë të lartë të humbjeve të ujit janë të ndryshme. Praktikisht të gjitha aspektet e veprimtarisë së KRUGJ, kanë ndikim në humbjet e ujit: gypat e vjetërsuar, ujëmatësit e vjetërsuar, leximi jo i duhur, faturimi jo real, etj.

Trendi i UPF gjatë 3 viteve të fundit është paraqitur në figurën në vijim.

Të dhëna për:	2021	2022	2023 Janar-Mars
Prodhimi (m ³)	15,910,071	16,177,553	3,668,224
Faturimi (m ³)	9,167,666	8,585,438	1,813,959
UPF (m ³)	6,742,405	7,592,137	1,854.265
UPF (%)	42,38%	46.93%	50.50%

3. CAQET E PËRCAKTUARA/Planifikimi

Pra është evidente se rritja e prodhimit të ujit nuk shoqërohet me rritjen e proporcionale të faturimit të ujit. Me të drejtë shkalla e lartë e humbjeve të ujit është identifikuar si një prej problemeve kryesore me të cilat ballafaqohet KRUGJ.

Caqet dhe dinamika e reduktimit të UPF-së, gjatë periudhës 2023-2025, janë dhënë në tabelën vijuese.

Vitet Planifikimi	2023	2024	2025
Prodhimi (m ³)	16,675,658	16,980,542	17,310,542
Faturimi (m ³)	8,940,556	9,339,298	9,693,904
UPF (m ³)	7,735,102	7,641,244	7,616,638
UPF (%)	46	45	44

Është e qartë se arritja e këtyre caqeve kërkon para së gjithash përkushtimin maksimal të menaxhmentit të KRUGJ, për shfrytëzimin efektiv të të gjitha resurseve njerëzore dhe financiare dhe mobilizimin e plotë të stafit të KRUGJ. Kjo nënkupton jo vetëm përcaktimin e prioriteteve dhe ndërmarrjen e veprimeve efektive operative, por para së gjithash adaptimin e metodologjive të duhura për hulumtimin, monitorimin dhe kontrollimin sistematik të humbjeve reale dhe humbjeve aparente.

KRUGJ, planifikon, që zvogëlimin e humbjeve për vitin 2023, ta ketë ndër 46%, por kjo varet, sa do të financohet në infrastrukturën ujore në ndërrimin e gypave, ujëmatësave por edhe leximin e saktë në teren.

Për arritjen e caqeve të përcaktuara KRUGJ, do të përqendrojë aktivitetet e veta në pesë shtylla kryesore:

1. Matja e plotë dhe e saktë e ujit të konsumuar;
2. Eliminimi i të gjitha parregullsive të lidhura me faturimin e saktë në bazë të konsumit real të konsumatorëve;
3. Identifikimi dhe legalizimi;
4. Shkyçja e të gjitha kyçjeve të paligjshme;
5. Detektimi dhe riparimi sistematik i të gjitha rrjedhjeve si dhe monitorimi i rrjetit distributiv;
6. Investime në rrjetin shpërndarës dhe ujëmatësit zonal.

4. REDUKTIMI I HUMBJEVE APARENTE - KOMERCIALE

Në parim humbjet aparente (ose siç njihen edhe si *humbjet komerciale*) përfshijnë:

- Shfrytëzimin e paautorizuar të ujit (keqpërdorimi i ujit)
 - Kyçjet ilegale
 - Manipulimi me ujëmatës
 - Vend rrjedhjet para ujëmatësit
- Gabimet në leximin e ujëmatësve
- Gabimet në faturim
- Pasaktësinë e regjistrimit të ujëmatësve
- Faturimin pa ujëmatës (paushall)

Prioriteti kryesor i Kompanisë në zvogëlimin e humbjeve të ujit është reduktimi i humbjeve aparente. Luftimi me sukses i këtyre humbjeve paraqet sfidë për Menaxhmentin e Kompanisë dhe pre supozon ballafaqimin me sukses me tri elementet menaxhuese:

- ***Menaxhimi e resurseve njerëzore (punëtorëve)***
- ***Menaxhimi e resurseve fizike (pajisjeve, para së gjithash ujëmatësve)***
- ***Menaxhimi e resurseve organizative (procedurat)***

Reduktimi i këtyre humbjeve nuk kërkon investime financiare të larta por para se gjithash përkushtim maksimal të menaxhmentit, prandaj mund të arrihen rezultate të konsiderueshme përmes ndërmarrjes së masave si:

- inspektimi dhe detektimi i kyçjeve ilegale të ujit;
- shkyçja/legalizimi i personave të kyçur ilegalisht;
- instalimi i ujëmatësve aty ku mungojnë;
- kalibrimi i ujëmatësve të dyshimtë;
- inspektimi i rregullte dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional;
- ngritja e saktësisë dhe përgjegjësisë në leximin e ujëmatësve;
- kontrollimi i leximeve nga kontrollat, etj.

4.1. Synimet Operative për Zvogëlimin e Humbjeve Aparente/Komerciale

Për të përmbushur caqet e përcaktuara sa i përket zvogëlimit të humbjeve të ujit në nivelet e planifikuara, KRUGJ, ka përcaktuar synimet specifike operative të cilat do të angazhohet ti përmbushë përmes aktiviteteve konkrete të planifikuara për arritjen e secilit prej synimeve operative veç e veç.

1. **Konsolidimi i data bazës së konsumatorëve:** Identifikimi, inçizimi dhe regjistrimi i të gjithë konsumatorëve në tërë zonën e shërbimit të KRUGJ;
2. **Eliminimi i lidhjeve ilegale dhe formave tjera të shfrytëzimit të paautorizuar të Ujit;**
3. **Faturimi i konsumatorëve që reflekton saktësisht ujin e konsumuar:** Instalimi i ujëmatësve për të gjithë konsumatorët dhe sigurimi i saktësisë së matjes dhe leximit.

KRU Gjakova, ka bërë investim në Mirëmbajtjen e sistemit ekzistues dhe implementimi i faturimit mobil në terren pritet të filloj së shpejti, i cili do ndikon dukshëm në saktësinë e matjes së ujit të shpenzuar.

4.2. Aktivitetet e Planifikuara

- Incizimi kyçjeve shtëpiake dhe ujëmatësve nga ekipet e KRUGJ;
- Azhurnimi sistematik i të dhënave të inqizuara në terren në data bazën e konsumatorëve nga Operatorët e GIS-it;
- Rritja e shkallës së faturimit në m³;
- Verifikimi i të gjitha rasteve të cilat aktualisht nuk faturohen-paushallin;
- Identifikimi dhe raportimi i kyçjeve ilegale nga lexuesit e ujëmatësve dhe kontrolla;
- Identifikimi dhe eliminimi i keqpërdoruesve të ujit;
- Instalimi i ujëmatësve të ri për zëvendësimin e ujëmatësve jofunksional;
- Pllombimi i të gjithë ujëmatësve.

KRUGJ, për të qenë më të saktë në gjetjen e kyçjeve ilegale ka planifikuar që nga viti 2019, të siguroi detektor me anë të cilit do të mund të detektoi deri në 6m thellësi gypat e ujit të diametrave të ndryshëm. Kështu që me këtë detektor mund të detektohen gypat ilegal aty ku dyshohet se mund të ekzistojnë

4. REDUKTIMI I HUMBJEVE REALE (FIZIKE)

Reduktimi i këtyre humbjeve kërkon investime financiare të konsiderueshme dhe njëkohësisht edhe përkushtim maksimal të menaxhmentit. Duke pasur parasysh mundësitë e limituara financiare të KRUGJ, aktualisht pjesa më e madhe e investimeve kapitale në reduktimin e humbjeve reale planifikohet të financohen nga donacionet, apo mbështetje financiare nga Qeveria e Kosovës.

5.1 Synimet Operative për Zvogëlimin e Humbjeve Reale/Fizike

Për të përmbushur caqet e përcaktuara sa i përket zvogëlimit të UPF-së, në nivelet e planifikuara me Planin e Biznesit 2023-2025, dhe me këtë plan, KRUGJ, ka përcaktuar synimet specifike operative për reduktimin e humbjeve reale (rrjedhjeve) të cilat do të angazhohet ti përmbushë përmes aktiviteteve konkrete të planifikuara për arritjen e secilit prej synimeve operative veç e veç.

1. Krijimi i një sistemi efektiv për identifikimin dhe riparimin e shpejtë të rrjedhjeve të dukshme (mbitokësore);
2. Hulumtimi, detektimi dhe riparimi sistematik i rrjedhjeve të padukshme (nëntokësore);
3. Rehabilitimi (zëvendësimi) i infrastrukturës së vjetruar të ujësjellësit;
4. Krijimi i zonave të matura (DMA-ve) për menaxhimin efektiv të UPF.

4.2. Aktivitetet e Planifikuara

- Riparimi i të gjitha vendeve të rrjedhjeve të regjistruara, sipas prioriteteve të përcaktuara (rëndësia e tubacioneve të dëmtuara për sistemin, madhësia e rrjedhjes, etj);
- Menaxhimi i presionit ne rrjet, që shpesh shkakton goditje hidraulike, dhe është shkak i dëmtimit të tubave dhe menaxhimi i mirë i presionit, redukton pjesën më të madhe të shkakut të dëmtimeve dhe zgjatë qëndrueshmërinë e instalimeve ekzistuese;
- Zëvendësimi dhe zhvendosje e ujëmatësve shtëpiak nga prona private në pronë publike (aty ku kemi mundësi teknike dhe financiare);
- Ngritja e cilësisë së materialeve të përdorura dhe të punëve montuese;
- Kontrollimi sistematik i rrjetit me qëllim të zbulimit të rrjedhjeve;
- Rehabilitimi/zëvendësimi i rrjetit shpërndarës të ujësjellësit bazuar në planin e menaxhimit të aseteve (aty ku kemi defekte të vazhdueshme);
- Instalimi/Ndërrimi i ujëmatësave zonal ne gjithë zonën e shërbimit;
- Monitorimi i UPF në kuadër të DMA-ve, dhe ujëmatësve zonal dhe përcaktimi i saktë i bilancit uhor për KRUGJ;
- Investime ne ndërrimin e gypave, ku kemi numër me të madh të defekteve (2 -I.4.6).
- Fushat sensibilizuese për vetëdijesimin e konsumatorëve për mos keqpërdorimin e ujit të pijshëm;

Shtojca I. Plani dinamik me aktivitetet e planifikuara për zvogëlimin e humbjeve aparente/komerciale

Nr.	Objektivi Strategjik, treguesit dhe veprimi	Afati kohor	Vlera bazë	Synimi i përkohshëm	Synimi i fund vitit 2023	Burimi i financimit	Rezultati		
I	Zvogëlimi i humbjeve aparente/komerciale		50%	47%	46%		Shfrytëzimi eficient i resurseve ujore dhe zvogëlimi i kostove operative		
	Aktiviteti		Tremujori II	Tremujori III	Tremujori IV		Institucioni udhëheqës/mbështetës	Produkti	Referenca në dokumente
1.1.	Hartimi i planit për zvogëlimin e humbjeve të ujit 2023	Maj/2023				KRU Gjakova	KRU Gjakova	Plani i aprovuar nga Bordi	Kërkesa nga NJPMNP/ME
1.2.	Inçizimi i kyçjeve shtëpiake dhe ujëmatësve nga ekipet e KRUGJ	Qershor-Dhjetor 2023	15.000	20,000	10,000	KRU Gjakova	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Komercial	Plani për zvogëlimin e humbjeve 2023
1.3	Azhurnimi sistematik i te dhënave ne data bazen e GIS-it	Qershor-Dhjetor 2023				KRU Gjakova	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Komercial	Te dhënat e regjistruara ne GIS
1.4	Rritja e shkalles se faturimit në m ³	Qershor-Dhjetor 2023				KRU Gjakova	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Komercial	Raportet tremujore dhe vjetor
1.5	Verifikimi i te gjitha rasteve pasive/paushalli	Qershor – Gusht 2023	10,000	6,000		KRU Gjakova	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Komercial	Raportet tremujore dhe vjetor
1.6	Identifikimi dhe raportimi i lidhjeve ilegale	Qershor-Dhjetor 2023				KRU Gjakova	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Komercial	Raportet tremujore dhe vjetor
1.7	Instalimi i ujëmatësve te rinjë /zëvendësimi i ujëmatësve jo funksional	Qershor-Dhjetor 2023	250	300	300	KRU Gjakova	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Komercial	Raportet tremujore, vjetore
1.8	Pllombimi i të gjithë ujëmatësve	Qershor-Dhjetor 2023	15.000	20,000	10,000	KRU Gjakova	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Komercial	Raportet tremujore, vjetore
	Buxheti i planifikuar					KRU Gjakova			
1.7	Vetanake					29.750.00€		Raporti Dep. i financave	Raporti vjetor 2023

Shtojca I.1. Plani dinamik me aktivitetet e planifikuara për zvogëlimin e humbjeve fizike/teknike

Nr.	Objektivi Strategjik, treguesit dhe veprimi	Afati kohor	Vlera bazë	Synimi i përkohshëm	Synimi i fund vitit 2023	Burimi i financimit	Vlera e planifikuar financiare/€	Rezultati		
2	Zvogëlimi i humbjeve fizike/teknike		50%	47%	46%			Shfrytëzimi eficient i resurseve ujore dhe zvogëlimi i kostove operative		
	Aktiviteti		Tremujori II	Tremujori III	Tremujori IV			Institucioni udhëheqës/mbështetës	Produkti	Referenca në dokumente
1.1.	Vendosja e standardit për riparim të defekteve brenda 24 h	2023				KRU Gjakova		KRU Gjakova	Plani i aprovuar nga Bordi	Raportet mujore
1.2.	Ngritja e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punëve montuese	2023				KRU Gjakova		KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Plani për zvogëlimin e humbjeve 2023
1.3	Kontrollimi sistematik i rrjetit, për identifikimin e rrjedhave	Qershor-Dhjetor 2023				KRU Gjakova		KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Te dhënat e regjistruara në GIS
1.4	Rehabilitimi/zëvendësimi i rrjetit shpërndarës /aty ku ka defekte të vazhdueshme	Qershor –Dhjetor 2023				KRU Gjakova		KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Raporti për ARRU dhe NJPMNP/ME
1.4.1	Dislokimi dhe Ndërrimi i gypit nga AC në PE në fshatrat Xërxe, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Denjë dhe Dobidol	Përfundon në muajin Maj 2023				Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, KRU Gjakova	MEA 350,000.00 € KRU Gjakova 146,354,68 Total: 496,354.68€	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Raporti nga Dep. Financiar. Biznes P.
1.4.2	Rehabilitimi i ujësjellësit – Stacioni i pompimit dhe furnizimi me ujë të pijshëm për fshatin Randobravë	Maj-Korrik 2023				KRU Gjakova, Komuna Prizren	55,961.17	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Raporti nga Dep. Financiar
1.4.3	Ndërrimi i gypave të ujësjellësit nga AC në PE100 RC, prej gjykatës deri te Emin Duraku.	Qershor – Shtator 2023				KRU Gjakova, Komuna Gjakovë	320,000.00	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Raporti nga Dep. Financiar. Biznes P.

1.4.4	Ndarja e zonës së parë nga zona e dytë në Rr: Xhelal Hajda -Toni, dhe Ndarja e zonës së dytë nga e zona e tretë (përfshirë gypa, pusea, ventila dhe kyqje)	Qershor – Shtator 2023				KRU Gjakova, Komuna Prizren	76,000.00	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Raporti nga Dep. Financiar. Biznes P.
1.4.5	Ndërrimi i gypave në disa lagje të këtyre fshatrave: Piranë, Krushë e Vogël	Qershor – Nëntor 2023				KRU Gjakova	42,500.00	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Raporti nga Dep. Financiar. Biznes P.
1.4.6	Instalim i ri apo zëvendësim i gypave në zonën e shërbimit (Ekipet e mirëmbajtjes)	Qershor – Dhjetor 2023				KRU Gjakova	30-50,000.00	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Plani për zvogëlimin e humbjeve 2023
1.5	Monitorimi i UPF-ve dhe ujëmatësave zonal dhe përcaktimi i sakte i bilancit ujorë	Qershor – Dhjetor 2023				KRU Gjakova		KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Raporti për ARRU dhe NJPMNP/ME
1.6	Instalimi i pajisjeve për reduktimin e presionit dhe monitorimi	Qershor – Dhjetor 2023				KRU Gjakova	5,000.00	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Plani për zvogëlimin e humbjeve 2023
1.7	Ndërrimi i ujëmatësve kryesor në Gjakova I Ø 500 & Gj-2 Ø 300 dhe ndarja për Rahovec Ø400	Qershor 2023				KRU Gjakova	9,000.00	KRU Gjakova	Raportet nga Departamenti Teknik	Raporti i Auditorit të jashtëm
	Buxheti i planifikuar									
	Vetanake dhe Komunit						1,054,815.85			